



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



U R D H Ë R

Nr. 118, datë 28.7.2022

P Ë R

NGRITJEN E KOMITETIT NDËRMINISTROR PËR MBROJTJEN KIBERNETIKE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 11, të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e Komitetit Ndërmínistror për Mbrojtjen Kibernetike, si organ konsultativ për çështjet e sigurisë për mbrojtjen e sistemeve shtetërore nga sulmet kibernetike.
2. Komiteti Ndërmínistror për Mbrojtjen Kibernetike të kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Ministrin e Mbrojtjes;
 - Ministrin e Brendshëm;
 - Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Informativ të Shtetit;
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).
3. Komiteti Ndërmínistror për Mbrojtjen Kibernetike ka si qëllim që të ndihmojë dhe të koordinojë strukturat shtetërore për çështjet e sigurisë për mbrojtjen e sistemeve shtetërore nga sulmet kibernetike, nëpërmjet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 118, datë 28.7.2022

PËR

NGRITJEN E KOMITETIT NDËRMINISTROR PËR MBROJTJEN
KIBERNETIKE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 11, të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e Komitetit Ndërmintor për Mbrojtjen Kibernetike, si organ konsultativ për çështjet e sigurisë për mbrojtjen e sistemeve shtetërore nga sulmet kibernetike.
2. Komiteti Ndërmintor për Mbrojtjen Kibernetike të kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Ministrin e Mbrojtjes;
 - Ministrin e Brendshëm;
 - Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Informativ të Shtetit;
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).
3. Komiteti Ndërmintor për Mbrojtjen Kibernetike ka si qëllim që të ndihmojë dhe të koordinojë strukturat shtetërore për çështjet e sigurisë për mbrojtjen e sistemeve shtetërore nga sulmet kibernetike, nëpërmjet

përcaktimit të politikave dhe harmonizimit të qasjeve zbatuese në fushat e përcaktuara.

4. Komiteti Ndërmínistror për Mbrojtjen Kibernetike ka për detyrë:
 - a) të përcaktojë politikat për mbrojtjen nga sulmet kibernetike;
 - b) të miratojë planin e veprimit dhe institucionet përgjegjëse për paraqitjen e propozimeve përkatëse dhe përmbushjen e detyrave të caktuara;
 - c) të analizojë e të përzgjedhë përvojat dhe modelet më të suksesshme, të cilat do të rekomandohen për zbatim;
 - ç) të mbikëqyrë zbatimin e politikave për mbrojtjen nga sulmet kibernetike;
 - d) të analizojë dhe të ofrojë zgjidhje për problematikat e hasura për çështjet e mbrojtjes kibernetike;
 - dh) të diskutojë çështje që lidhen me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të mbrojtjes kibernetike;
 - e) të diskutojë dhe të rekomandojë nisma të ndryshme ligjore që prekin direkt apo tërthorazi çështje që lidhen me mbrojtjen kibernetike.
5. Në varësi të çështjeve që do të diskutohen, në mbledhjet e Komitetit thirren të marrin pjesë dhe titullarë ose drejtues të ministrive të linjës e të institucioneve qendrore.
6. Në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organizatave e organizmave të huaj, të rretheve akademike, grupeve të interesit si dhe ekspertë të fushës, vendas e të huaj.
7. Komiteti, gjatë kryerjes së funksioneve të tij, mbështetet në veprimtarinë e strukturave përgjegjëse dhe të grupeve të punës të ngritura posaçërisht për mbrojtjen kibernetike.
8. Si sekretariat teknik për mbështetjen e punës së këtij Komiteti të shërbejë Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).
9. Sekretariati teknik të organizojë dhe të përgatitë dokumentacionin e mbledhjes së komitetit, të mbajë procesverbalin, të bëjë zbardhjen e vendimmarrjes dhe të çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, të komunikojë me institucionet dhe të përcjellë porositë e tij si dhe të kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga komiteti, në përmbushje të përgjegjësisë së veta.
10. Komiteti Ndërmínistror për Mbrojtjen Kibernetike të mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe sa herë që është e nevojshme, me njoftimin e kryetarit.

11. Ngarkohet Komiteti Ndërmnistror për Mbrojtjen Kibernetike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 4426
DATE 28.7. 2022

MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT
AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN
ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE
KOMITETIT NDËRMINISTOR TË MBROJTJES
KIBERNETIKE

Sekretari i Përgjithshëm



Engjëll AGACI